

VENDIM
Nr.144, datë 8.3.2006

**PËR BOTIMIN, SHTYPJEN DHE SHPËRNDARJEN E TEKSTEVE SHKOLLORE,
TË SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9,56 e 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës miraton tekste shkollore alternative për arsimin parauniversitar, të cilat konkurrojnë në kushtet e barazisë së plotë, me përzgjedhje nga përdoruesit. Kriteret dhe procedurat për këtë proces përcaktohen me udhëzim të Ministrit.

2. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës nuk ushtron më funksione botimi, shtypjeje dhe shpërndarjeje të librit shkollor, si dhe nuk përdor fonde për subvencion të drejtpërdrejtë në procesin e prodhimit të teksteve shkollore.

3. Procesi i botimit, shtypjes dhe shpërndarjes së teksteve shkollore të arsimit parauniversitar do të bëhen nga shtëpitë botuese.

4. Vlerat e përcaktuara si subvencion nuk do të përdoren drejtpërdrejt për uljen e çmimeve të teksteve, por do të përdoren nga përdoruesi, për të përballuar diferencën e çmimit të shitjes.

5. Në rastet e subvencionimit të teksteve shkollore, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, fondet e miratuara për këtë qëllim, i kalon në përdorim të drejtpërdrejtë të shkollës/përdoruesit.

6. Për shkollat e arsimit bazë dhe shkollat e mesme, në qendër bashkie a komune ose, sipas rastit, për çdo shkollë ose grup shkollash, të çelen numra llogarie pranë degëve të thesarit në rrethe.

7. Për të gjitha shkollat e tjera, 9-vjeçare dhe të mesme, që nuk ndodhen në qendër bashkie a komune, si dhe shkollat e tjera, që nuk kanë standardet dhe infrastrukturën e nevojshme për t’iu mundësuar çelja e llogarive buxhetore, ky proces do të realizohet përmes llogarisë buxhetore të zyrës arsimore në rreth.

8. Masat e subvencionit do të likuidohen nga përdoruesi, në llogarinë e shtëpisë botuese, pas dorëzimit të teksteve të porositura.

9. Procedurat e përdorimit të fondeve buxhetore, të miratuara për subvencion, për blerjen e teksteve shkollore, përcaktohen në udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës dhe Ministrit të Financave.

10. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

11. Pika 1 e vendimit nr.136, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave “Për shpërndarjen e teksteve shkollore të arsimit parauniversitar” dhe pika 1 e vendimit nr.237, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave “Për shtypjen dhe shpërndarjen e teksteve shkollore të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2004-2005”, si dhe të gjitha aktet nënligjore, që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha